



**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**

**Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është agjenci e pavarur, e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas neneve 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**

**ZRRE bën rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë (Energji Elektrike, Ngrohje Qëndrore dhe Gaz Natyror).**



## Vendimet e lëshuara nga ZRRE gjatë periudhës Janar - Qershor 2012

Vendimi V\_395\_2012 për Autorizimin Preliminar –Eurokos-JH Loreto Consult AG

Vendimi V\_396\_2012 për Derogimin e disa Neneve të Licencave të KEK Sh.A

Vendimi V\_397\_2012 për Derogimin e disa Neneve të Kodit të Shpërndarjes

Vendimi V\_398\_2012 Apropohet ankesa e konsumatorit Steda Kosova

Vendimi V\_399\_2012 për Përcaktimin e parametrave kyçë

Vendimi V\_400\_2012 Kontesti KOSTT-KEK

Vendimi V\_401\_2012 për Vazhdim të Licencës për furnizim/tregti për RUDNAP GROUP AD

Vendimi V\_402\_2012 për Autorizim të KELKOS ENERGY SH.P.K

Vendimi V\_403\_2012 për Transfer të aseteve 400/220/110kV nga KEK SH.A në KOSTT SH.A

Vendimi V\_404\_2012 për Amandamente të dispozitave të Kodit të Kycjes

Vendimi V\_405\_2012 për Vazhdim të Afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Preliminar për KTW Sh.p.k

Vendimi V\_406\_2012 për Apropim të të hyrave maksimale të lejuara (MAR) - SHTE6 KEK OSSH

Vendimi V\_407\_2012 për Apropim të të hyrave maksimale të lejuara (MAR) - SHTE6 KOSTT

Vendimi V\_408\_2012 për Apropim të të hyrave maksimale të lejuara (MAR) për OSSH - KEK Gjenerimi

Vendimi V\_409\_2012 për Apropimin e Tarifave me pakicë për konsumatorët e rregulluar

Vendimet 409-417 ankesa të konsumatorëve (7 refuzime të ankesave të konsumatorëve)

## Pjesëmarrja e ZRRE-së në konferenca, seminare, mbledhje ndërkombëtare, Janar – Qershor 2012

**25.01.2012** – Tryezë punuese në kuadrin e studimit “Rekomandimet e cilësisë së shërbimit, mbledhjes së të dhënave, raportimin dhe auditimin në Komunitetin e Energjisë”, Vjenë

- Fokusi i kësaj tryeze punuese ka qenë përmbledhja e aktiviteteve të caktuara më herët për shtetet anëtare nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë lidhur me cilësinë e shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike në Komunitetin e Energjisë si dhe udhëzimet e përgjithshme për rregullimin e cilësisë së shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike, ku në fokus të veçantë është diskutuar për kontinuitetin e furnizimit me energji elektrike, cilësinë e tensionit dhe cilësinë komerciale.

**26.01.2012** – Takimi i rregullt i Grupit Punues për Konsumator në kuadër të ECRB, Vjenë

---

Të gjithë Rregullat dhe Vendimet e ZRRE-së janë në dispozicion në: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

- Fokusi i këtij takimi është përmbledhja e të gjitha aktiviteteve dhe detyrave të caktuara në Grupin Punues për konsumator në kuadër të ECRB për katërmujorin e kaluar si dhe caktimi i detyrave të reja për katërmujorin e ardhshëm.

**27.02-01.03.2012-** Pjesëmarrje në trajnimin e ERRA-së lidhur me Rregullimi i çmimeve dhe tarifave mbajtur në Budapest-Hungari;

**(19-20).03.2012** – Pjesëmarrje në ERRA - Takim i Grupit Punues për Rregullim Ligjor, Budapest, Hungari

- Në takim përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse marrin përvojat më të mira për funksionim sa më të mirë të rregullatorëve dhe ndërmarrjeve në sektor të energjisë.

**19.04.2012** – Takimi i rregullt i Grupit Punues për Konsumator në kuadër të ECRB, Vjenë

- Fokusi i këtij takimi është përmbledhja e të gjitha aktiviteteve dhe detyrave të caktuara në Grupin Punues për konsumator në kuadër të ECRB për katërmujorin e kaluar si dhe caktimi i detyrave të reja për katërmujorin e ardhshëm.

**20.04.2012** - Tryeza punuese për Studimin mbi Dialogun Social në vendet e Ballkanit Perëndimor

- Fokusi i kësaj tryeze punuese ka qenë diskutimi i pjesëmarrësve për të dhënë kontributin e tyre në forcimin e dialogut social në mes Palëve të Komunitetit të Energjisë Kontraktuese me fokus të veçantë në Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për të promovuar dialogun social në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

**08.05.2012** - Mbledhja e 22-të të Grupit Punues të Gazit në kuadër të ECRB TKE EJJ, në Vjenë;

- Ndër temat kryesore të mbledhjes së rregullt të Grupit Punues të Gazit kanë qenë: i) shqyrtimi i aktiviteteve konkrete drejt progresit të iniciativës “elektricitet nga gazi natyror” (“gas to power initiative” si nxitëse në realizimin e Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë; dhe ii) elaborimi i aspekteve rregullative për realizimin e Unazës së gazit – konkretisht shqyrtimi dhe vlerësimi i përmbajtjes së draft dokumentit: Vlerësimi Praktik i Kornizës Rregullative për segmentin verior dhe atë jugor të Unazës e Gazit, që përfshin edhe segmentin Kosovarë të Unazës.

**(23-24).05.2012** - Pjesëmarrje në ERRA – takimi i 12 i Asamblesë Gjenerale dhe Komiteti i tarifave të ERRA Bratislava, Sllovaki;

**(22-23).05.2012** - Përfaqësimi i ZRRE-së në takimin e Dialogut për Procesin e Stabilizim- Asocimit në fushën e Mjedisit, Transportit, Energjisë dhe Zhvillimit Rajonal lidhur me Tarifat e energjisë, Bruksel-Belgjikë

- Axhustimet vjetore, arritja e mbulimit të kostove, reduktimi i subvencioneve qeveritare dhe feed-in tarifa për promovimin e burimeve të ripërtitshme.

## **Pjesëmarrja e ZRRE-së në takime, punëtori dhe seminare vendore gjatë periudhës Janar- Qershor 2012**

**12.01.2012** – Takimi në KEK lidhur me Balancën e Energjisë Elektrike- humbjet komerciale.

**19.01.2012** – Takimi në KOSTT për Rregullat e Tregut.

**23.01.2012** - Takim me përfaqësuesit e KOSTT-it për transferin e aseteve në kuadër të SHTE6;

**23.01.2012** – Takimi në ZRRE me përfaqësues të KOSTT-it për transferin e aseteve në kontestin e aplikacionit për tarifa.

**23.01.2012** – Takimi në ZRRE me përfaqësuesit e KEK-ut lidhur me Kontestin në mes KFOR dhe KEK;

**24.01.2012** – Tryezë pune organizuar nga IPF ku është prezantuar dhe shqyrtuar Studimi i Fizibilitetit financiar nga BE “ Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në Komunitet e Kosovës”;

**26.01.2012** - Takim me përfaqësuesit e KEK-ut lidhur me verifikimin e shpenzimeve operative dhe kapitale në kuadër të SHTE6;

**31.01.2012** - Takim në KOSTT me përfaqësuesit e KOSTT-it lidhur me përcaktimin e RAB/RABf;

**02.02.2012** – Takimi në KEK lidhur me humbjet dhe faturimin;

**03.02.2012** – Takimi në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) me përfaqësuesit e projektit “Kosova e Re”, Këshilltarët e Transakcionit, Përfaqësuesit e NQ Termokos dhe KEK-ut për të diskutuar dhe shqyrtuari draft Marrëveshjet për furnizim me energji termike, TC Kosova B – NQ Termokos, si dhe komenteve të hartuara nga palët e interesit përfshirë edhe komentet e ZRRE-së;

**07.02.2012** – Takimi në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) me përfaqësuesit e projektit “Kosova e Re”, Këshilltarët e Transakcionit, Përfaqësuesit e NQ Termokos dhe KEK-ut për të diskutuar dhe shqyrtuari draft Marrëveshjet për furnizim me energji termike, TC Kosova B – NQ Termokos, si dhe komenteve të hartuara nga palët e interesit përfshirë edhe komentet e ZRRE-së;

**(09 – 10).02.2012** – Punëtorja e organizuar në KOSTT për Rregullat e Tregut.

**20.02.2012** – Takimi në ZRRE me KEK-un për harmonizimin e të dhënave për hartimin e Raportit Vjetor të ZRRE-së 2011.

**22.02.2012** – Takimi në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) lidhur me kontestin në mes KFOR dhe KEK;

**24.02.2012** – Takimi në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) lidhur me kontestin në mes KFOR dhe KEK;

**28.02.2012** - Takim me përfaqësuesit e KELKOS Sha, konsultime për tarifën e HEC-eve;

**28.02.2012** – Takimi në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) me përfaqësuesit e projektit “Kosova e Re”, Këshilltarët e Transakcionit, Përfaqësuesit e NQ Termokos dhe KEK-ut për të diskutuar dhe shqyrtuari draft Marrëveshjet për furnizim me energji termike, TC Kosova B – NQ Termokos, si dhe komenteve të hartuara nga palët e interesit përfshirë edhe komentet e ZRRE-së;

**15.03.2012** - Takim me përfaqësuesit e Komisionit Kosovar të Konkurrencës lidhur me koordinimin e aktiviteteve ZRRE-KKK;

**15.03.2012** – Pjesëmarrja në konferencën e organizuar nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në kuadër të MTI-së lidhur me temën Roli dhe rëndësia e mbrojtjes së konsumatorëve në Kosovë;

**21.03.2012** - Takim me përfaqësuesit e KEK-ut lidhur me transferin e aseteve nga KEK në KOSTT ShA;

**23.03.2012** - Takim me përfaqësuesit e Wind Power ShA lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Tarifës;

**27.03.2012** – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e HANDIKOS-it lidhur me faturimin e energjisë elektrike që ju bëhet kësaj organizate joqeveritare;

**28.03.2012** – Takimi në KOSTT për harmonizimin e kodeve Teknike me ndryshimet në legjislacion.

**28.03.2012** - Takim në ZRRE me përfaqësuesit e KOSTT-it për transferin e aseteve në kuadër të SHTE6;

**02.04.2012** - Takim në ZRRE me përfaqësuesit e KOSTT-it për të diskutuar për të dhënat që KOSTT i ka marrë nga KEK lidhur me vlerën e aseteve që do të transferohen nga KEK në KOSTT si dhe shpenzimet të cilat duhet të përfshihen në të Hyrat Maksimale të Lejuara për SHTE6;

**02.04.2012** – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në kuadër të MTI lidhur me mundësinë e organizimit të një tryeze punuese me të gjithë institucionet përgjegjëse për shërbime publike me temën “Shërbimet publike në funksion të mbrojtjes së konsumatorit”;

**03.04.2012** – Takimi i 20-të i Grupit Punues për Qeverisjen e Kodeve Teknike Operacionale;

**05.04.2012** - Takim i Steering Committee lidhur me Raportin e Përkohshëm të Progresit;

**20 prill 2012** – Takim në MZHE për finalizimin e komenteve në Strategjinë Rajonale të Komunitetit të Energjisë;

**20.04.2012** – Takimi në MZHE për analizimin dhe shqyrtimin e dispozitave të Direktivës 2009/73/EC dhe Rregullores EC 715/2009 (për gaz natyror) të cilat janë të traspozuar në legjislacionin tonë përkatës, si dhe hartimi i dokumentit përkatës për t’u dorëzuar në TKE;

**24.04.2012** – Takimi në MZHE për analizimin dhe shqyrtimin e dispozitave të Direktivës 2009/73/EC dhe Rregullores EC 715/2009 (për gaz natyror) të cilat janë të traspozuar në legjislacionin tonë përkatës, si dhe hartimi i dokumentit përkatës për t’u dorëzuar në TKE;

**02.05.2012** - Takim me MZHE lidhur me tarifat nxitëse( feed-in);

**03.05.2012** – Takimi me përfaqësues të USAID për procesin e tarifave disavjeçare.

**03.05.2012** – Takimi në ZRRE me përfaqësues të KOSTT-it për studimin për Sigurinë e furnizimit me energji.

**(03-05).05.2012** – Takimi në MZHE për vlerësimin e ofertave për privatizimin e distribucionit dhe furnizimit (në cilësinë e vëzhguesit).

**08.05.2012** -Takim me përfaqësuesit e KOSTT Sha lidhur me Formularët e Raportimit Rregullativ SHTE7;

**07.06.2012** – Tryezë punuese lidhur me “Shërbimet publike në funksion të mbrojtjes së konsumatorit” e organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Prishtinë;

**08.06.2012** – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e KEK-ut lidhur me Procedurën për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike;

**08.06.2012** – Takim në ZRRE me përfaqësuesit e KFOR-it (HQ) lidhur me kontestin në mes KFOR dhe KEK;

**12-13.06.2012** – Takimi në Durrës për planin e Biznesit;

**20.02.2012** – Takim në Kuvendin e Kosovës me Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë,Tregti dhe Industri për dëgjim publik lidhur me Projektligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve;

**21.06.2012** - Takim me përfaqësuesit e KOSTT lidhur me Formularët e Raportimit Rregullativ;

**22.06.2012** – Takimi në KOSTT për Dizajnin e Tregut dhe Rregullat e Tregut – çështje për shqyrtim.

**27-28.06.2012** – Trajnimi i organizuar nga USAID-i për Komisionerët e rinj.

## **Aktivitetet e ZRRE-së për periudhën Janar - Qershor 2012**

Aktivitetet e DTÇ-së gjatë gjysmës e parë të vitit 2012 mund të ndahen në 3 drejtime kryesore:

- Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike (SHTE6);
- Shqyrtimi i shtatë i tarifave të energjisë elektrike (SHTE7);
- Shqyrtimi i humbjeve, MPKK-së dhe parametrave të tjerë rregullator.

Në vijim po i paraqesim një përmbeldhje të aktiviteteve të lartpërmendura me të cilat është angazhuar DTÇ gjatë kësaj periudhe raportuese:

Njoftimi i të licencuarve dhe palëve të interesit lidhur me Shqyrtimin e gjashtë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE6);

Përgjigjet në pyetësorin e kompanive të parakualifikuara për transaksionin e KEDS-it;

Përgatitja dhe shpërndarja e formularëve të shabllonizuar në kuadër të SHTE6 të licencuarve të KEK dhe KOSTT ShA;

Përcaktimi i parametrave kyç rregullator që përdoren për llogaritjen e Të Hyrave të Lejuara dhe Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike për TSHV;

Përgatitja dhe shpërndarja i Raporteve Konsultative të Zyrës së Rregullatorit për Energji, lidhur me aplikacionet e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT);

Njoftimi për shqyrtimin e shtatë të tarifës (shumë-vjeçare) së energjisë elektrike (SHTE7),

Publikimi i Raportit Konsultativ për iniciimin e SHTE7 dhe Formularëve Raportues të të licencuarit;

Aprovimi i tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të zbatohen nga KEK-SH.A. nga data 1 qershor 2012;

Aprovimi i Hyrave maksimale të lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT) , Gjeneratorët e rregulluar TC "AB" dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për vitin relevant (tarifor) prej 12 muajve nga 1 prill 2012 deri më 31 mars 2013.

SHTE6 ka përfunduar më 20 qershor me rastin e marrjes së Vendimit të Bordit të ZRRE-së për tarifën me pakicë të energjisë elektrike të cilat janë të aplikueshme nga data 1 qershor 2012 deri më 31 mars 2013. Pas përfundimit të procesit, DTÇ ka njoftuar vazhdimisht publikun për rezultatet e SHTE6 kryesisht përmes prononcimeve mediale dhe pjesëmarrjeve në debate publike televizive.

Që nga data 23 prill 2012 ZRRE ka filluar përgatitjet për Shqyrtimin e shtatë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE7). Ky do të jetë shqyrtimi i parë i tarifave që ju nënshtrohet plotësisht rregullave të reja të përcaktimit të çmimeve dhe shqyrton të hyrat e lejuara të të licencuarve për një periudhë 5 vjeçare. Tarifën e reja që rrjedhin si rezultati i këtij shqyrtimi pritet të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2013.

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit (DLL) gjatë kësaj periudhe ka harmonizuar licencat në përputhje me ndryshimet e legjislacionit primar dhe sekondar. Të gjitha licencat e harmonizuara kanë kaluar nëpër konsultim publik dhe komentet e palëve të interesit janë përfshirë në to.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese DLL ka pranuar disa aplikacione për Autorizim për ndërtim të kapaciteteve gjeneruese të cilat janë në shqyrtim e sipër, ndërsa me 15 Qershor 2012 Bordi i ZRRE-së ndërmarrjes “Kelkos Energy” sh.p.k i ka lëshuar Autorizimin për ndërtimin e Hidrocentralit që përbëhet prej dy njësive gjeneruese “HC Belaja” me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW dhe “HC Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, në total 17.6 MW.

Departamenti i Tregut gjatë kësaj periudhe raportuese janar- qershor është angazhuar në monitorimin e ndërmarrjeve energjetike përmes analizimit të të dhënave ditore dhe mujore që pranohen nga të licencuarit në bazë të rregulltë.

Po ashtu janë analizuar dokumente të ZRRE-së dhe të licencuarve, si dhe ato të arritura nga institucionet vendore apo ndërkombëtare.

DTE është angazhuar në plotësimin e pyetësorëve të arritur nga institucionet vendore apo ndërkombëtare.

Ka pasur rol të veçantë në përgatitjen e Raportit vjetor 2011 të ZRRE-së ku përveç përgatitjes së pjesës për energji elektrike është marrë edhe me përgatitjen e tabelave dhe grafikoneve për tërë raportin si dhe për dizajnin në përgjithësi të dokumentit.

DMK gjatë kësaj periudhe raportuese janar – qershor ka qenë e angazhuar në mbrojtjen e konsumatorëve duke bërë shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve si dhe të kontesteve në mes të licencuarve. Po ashtu ka qenë e angazhuar në biseda direkte me palët duke i njoftuar ata me të drejtat e tyre që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë analizuar procedura dhe dokumente të ZRRE-së dhe të licencuarve, si dhe të ato ndërkombëtare.

DMK ka qenë e angazhuar edhe në plotësimin e pyetësorëve të arritura nga institucionet vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Ndërsa më poshtë po i paraqesim disa nga aktivitetet e realizuara në sektorin e ngrohjes qendrore:

Përgatitja e Raportit vjetor të ZRRE – pjesët e raportit për ngrohje qendrore dhe gaz natyror.

Monitorimi i rregullt i Ndërmarrjeve të NQ – analizimi i të dhënave, informatave të dërguara nga ndërmarrjet e ngrohjes qendrore.

Analizimi, komentimi dhe finalizimi i draft dokumenteve të përgatitura nga Ndërmarrjet e ngrohjes qendrore, të dorëzuara për aprovim në ZRRE, si në vijim: i) Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë të Sistemit të Shpërndarjes; ii) Draft Marrëveshja për furnizim me energji termike TC Kosova B – NQ Termokos .



Pjesëmarrja në grupet punuese për vlerësimin e aplikacioneve për autorizim e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese, sidomos të atyre të gjenerimit nga era dhe hidrocentraleve të vogla.

Përcjellja e zhvillimeve rajonale lidhur me çështjet e gazit natyror, veçanërisht në kuadër të Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore (KEEJL) – pjesëmarrja në punën e Grupit Punues të Gazit të ECRB, Forumin e Gazit dhe në aktivitetet tjera relevante organizuar nga Sekretariati i KEEJL.

Shqyrtimi dhe analizimi i raporteve me informatat dhe të dhënat faktikisht të realizuara nga ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në sezonin 2011/2012, me qëllim të krahasimit dhe bashkërendimit me të dhënat përkatëse të planifikuara për përcaktimin e të Ardhurave të lejuara dhe tarifave për sezonin 2011/2012.

Analizimi, komentimi dhe përgatitja e dokumenteve të ndërlidhura me gazin natyror dhe punën e GPG të ECRB - TKE, si pyetësorët, raportet dhe dokumentet tjera relevante: i) Plotësimi i pyetësorit për licencimin; ii) plotësimi i të dhënave dhe informatave për hartimin e dokumentit Vlerësimi Praktik i Kornizës Rregullative për Unazën e Gazit – segmenti verior dhe ai jugor; iii) plotësimi i pjesëve përkatëse të pyetësorit të studimit të fizibilitetit për integrimin e Kosovës në BE; iv) plotësimi i pyetësorit Integrimi i Biogazit në Rrjetet e Gazit Natyror

Përcjellja e mbarëvajtjes së gjithmbarshme të projektit të ECLD-së “Asistencë ZRRE-së” dhe koordinimi me kompaninë këshillëdhënëse (LDK) në cilësinë e “kundër-palës” – personit përgjegjës nga ZRRE.

## **Aktivitetet e planifikuara të ZRRE-së për periudhën korrik – dhjetor 2012**

- Aprovimi i Dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës;
- Vlerësimi dhe Komentimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike;
- Vlerësimi i aplikacioneve për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese;
- Aprovimi i licencave të harmonizuara në përputhje me ndryshimet në ligjet primare dhe legjisllacionin sekondar;
- Analiza, komentimi dhe vlerësimi i dokumenteve përkatëse të dorëzuara në ZRRE për aprovim nga të licencuarit;
- ZRRE është duke vlerësuar përballueshmërinë e tarifave nga konsumatorët shtëpiak me njëhisorë 2-tarifor për të vendosur mbi arsyeshmërinë e vazhdimin të aplikimit të bllok-tarifës për këta konsumatorë. Për të përmbushur kërkesat e Nenit 40 të Ligjit për Rregullatorin e

Energjisë, ZRRE është duke studiuar strukturën ekzistuese të tarifave për të evidentuar ndër-subvencionimin eventual në mes të kategorive të ndryshme të konsumatorëve. Rezultatet e këtyre dy studimeve do të publikohen në gjysmën e dytë të vitit.

- Shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesave të konsumatorëve si dhe kontesteve në mes të licencuarve;
- Përgatitja e Procedurës për monitorimin e standardeve të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike;
- Shqyrtimi i ardhshëm i tarifave të ngrohjes qendrore dhe hartimi final i dokumenteve përkatëse si: Raportet për Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara dhe për Llogaritjen dhe Përcaktimin e Tarifave;
- Monitorimi i përmbushjes së kushteve dhe kërkesave që rrjedhin nga licencat e kompanive të ngrohjes qendrore;
- Kompletimi i kornizës rregullative për ngrohjen qendrore; veçanërisht finalizimin e Rregullit për Përcaktimin e Çmimeve të Ngrohjes Qendrore, dhe Metodologjisë Tarifore, si dhe finalizimi i modelit tarifor dhe dokumenteve tjera përkatëse;
- Pjesëmarrje në mekanizmat e TKE EJK për çështjet lidhur me gazin natyror – Grupi punues i gazit i ECRB, Forumi gazit dhe aktivitete tjera përkatëse;
- Analizimi, komentimi dhe përgatitja e dokumenteve të ndërlidhura me gazin natyror dhe punën e GPG të ECRB - TKE, si pyetësorët, raportet dhe dokumentet tjera relevante;